



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al)

**Nr.1**

**10 janar**

**2008**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.6, datë 4.1.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e institucioneve të autorizuara për verifikimin, në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit”.....	3
Vendim i KM nr.7, datë 4.1.2008	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Ashtë”, si propozim i kërkuar .....	3

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 4.1.2008**

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.824, DATË 6.12.2006 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR  
VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË  
FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006, “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 1 shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Institucionet e tjera, që kërkojnë të autorizohen për verifikim, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore i paraqesin kërkesë Ministrit të Drejtësisë.”.

2. Pas pikës III shtohet pika III/1, me këtë përmbajtje:

“III/1. Institucionet e parashikuara në pikën 1 konfirmojnë gjendjen gjyqësore të personit të deklaruar në formularin e vetëdeklarimit nëpërmjet sistemit elektronik *fingerprint* dhe nuk mund të kërkojnë më paraqitjen e dëshmisë së penalitetit, të lëshuar nga zyra e gjendjes gjyqësore. Përfshirë nga ky rregull bën institucioni i prokurorisë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 7, datë 4.1.2008**

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME  
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “ASHTË”, SI PROPOZIM I KËRKUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 16 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), si propozim i kërkuar, të hidrocentralit “Ashtë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Vendimet nr.430, datë 10.12.1990 “Për miratimin e studimit të projektit të Bushatit”, nr.89, datë 19.2.1996 “Për miratimin e firmës me të cilën do të kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit”, nr.586, datë 8.9.1998 “Për miratimin e firmës me të cilën do të kontraktohet ndërtimi i hidrocentralit të Bushatit dhe procedurat deri në lidhjen e kontratës” dhe nr.598, datë 13.11.2000 “Për miratimin në parim, të financimit për ndërtimin e hidrocentralit të Bushatit dhe lejimin e KESH-it për prokurim të drejtpërdrejtë me kompaninë CWE”, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)**  
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.

## BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET

### BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

### *Së shpejti në treg:*

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 10.1.2008  
Doli nga shtypi më 10.1.2008

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”  
Tiranë, 2008

Çmimi 4 lekë